



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE/MODULEVE TË TRAJNIMIT

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 03.12.2021

Njoftim për “Vlerësues të moduleve/programeve të trajnimit”

Në mbështetje të udhëzimit nr.16, datë 28.07.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” dhe në dokumentin nr. 4186/4 prot, datë 30.08.2021 “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë, në arsimin parauniversitar për periudhën 2021-2025”, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, njoftohen të gjithë personat e interesuar se KAPT-i shpall kërkesën për **“Vlerësues të moduleve/programeve të trajnimit”** në fushat:

- Përdorimi i TIK në mësimdhënie – nxënie
- Kurrikula
- Mësimdhënia - të nxënësve - vlerësimi i nxënësve
- Etika, komunikimi dhe pedagogjia
- Drejtimi i shkollës dhe zhvillimi profesional i mësuesve
- Gjithëpërfshirja

Vlerësuesit e moduleve/ programeve të trajnimit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Mësues, ose specialistë të fushës së arsimit parauniversitar që zotërojnë njohuri të mjaftueshme për modulin.
- b) Profesorë, lektorë, asistent-lektorë të institucioneve të arsimit të lartë në fushën e edukimit me ekspertizë në modulin përkatës.
- c) Mësues, drejtues që janë vlerësuar “Shkëlqyeshëm” ose “Shumë mirë” në provimin e fundit të kualifikimit me ekspertizë në modulin përkatës.
- d) Drejtorë që drejtojnë një nga shkollat e sukseshme në një nga dy vitet e fundit shkollore.

Vlerësuesit e moduleve/ programeve të trajnimit nuk lejohet të jenë:

1. Autorë të moduleve/programeve të trajnimit.
2. Punonjës me kohë të plotë ose të pjesshme në agjencitë që aplikojnë për të akredituar modulet/programet e trajnimit.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a. Jetëshkrimi (CV-ja).
- b. Vërtetim pune.
- c. Fotokopje e diplomës së institucionit të arsimit të lartë.
- d. Fotokopje të certifikatave të ndryshme në lidhje me modulën përkatës.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen me postë pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) me adresë:
Rruga Naim Frashëri, Nr.37, Tiranë.

Afati i dorëzimit të dokumenteve është 06 dhjetor – 17 dhjetor 2021.

Faleminderit!